



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

PROJEKTI FITUES ME TITULL:

**“ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS NË SHËRBIM
TË FUQIZIMIT TË KËRKUESËVE TË RINJ
DHE TË STUDENTËVE”**

FINANCUAR NGA MINISTERIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT PËR
VITIN AKADEMIK 2022-2023



Ekipi i projektit:

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA (koordinatore)

Prof. Asoc. Dr. Anida KISI

Prof. Asoc. Dr. Ogerta KORUTI

Prof. Asoc. Dr. Etleva KONDI

Dr. Elvana SHTËPANI

Përshkrim i përgjithshëm i punës në fazën e parë:

NGRITJA E INFRASTRUKTURËS KËRKIMORE-SHKENCORE

Projekti me titull "Zhvillimi i infrastrukturës në shërbim të fuqizimit të kërkuesëve të rinj dhe të studentëve" u propozua në përgjigje të thirrjes për projekte të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, bazuar në Urdhër të Ministrit Nr. 360 datë 28.06.2022 “Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit për vitin akademik 2022-2023.

Ky projekt-ide u propozua nga një grup profesorësh dhe kërkuesish shkencorë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe erdhi në kuadër të ndryshimeve thelbësore pas situatës së pandemisë si dhe në përmbushje të nevojave të domosdoshme për t’i shërbyer stafit akademik dhe studentëve të të tre cikleve të studimit në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës.

Grupi i punës ka përcjellë menjëherë për zbatim projektin fitues për krijimin e infrastrukturës bashkëkohore dhe digjitale me ngritjen e tre laboratorëve kërkimorë për t’u vënë në dispozicion kërkuesve të rinj shkencorë dhe studentëve të FGJH-së hapësira të digjitalizuar me qëllim realizimin e kërkimit shkencor dhe procesin mësimor. Laboratorët e ngritur kanë pajisje të reja si: kompjutera, laptopë, projektorë, regjistruer si dhe pajisje të tjera të nevojshme për një funksionim sa më të mirë dhe efikas.



Në këta laboratorë janë instaluar pajisje dhe teknologji të reja për realizimin e veprimtarisë akademike, didaktike, kërkimore si dhe përvetësimin e kompetencave të reja në fushën e inteligjencës artificiale. Ata u krijuan të funksionojnë si qendër kërkimore, sallë mësimore por edhe sallë realizimi konferencash apo takimesh shkencore të kërkuesve në UT dhe jo vetëm. Këta laboratorë kanë një vlerë të rëndësishme që studentët dhe kërkuesit e rinj të gjejnë infrastrukturën e nevojshme në mënyrë që të realizojnë jo vetëm procesin mësimor por edhe punën kërkimore.

Laboratori 210 “DiPLing”

(Didaktikë e Gjuhëve të Huaja, Përkthim, Letërsi, Linguistikë)



Laboratori 211



Laboratori 212

